

VENDIM

Nr. 775, datë 30.9.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR HARTIMIN E STUDIMPROJEKTIMIT PËR REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO-ROMANOS – KËNETË DHE SISTEMIMI I RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRESIT

(Ndryshuar me vendimin nr. 213, datë 31.3.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 88 128 502 (tetëdhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e dy) lekë pa TVSH, për hartimin e studimprojektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, të detajuar, si më poshtë vijon:

a) për vitin 2020, në masën 51 550 000 (pesëdhjetë e një milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH;
b) për vitin 2021, në masën 36 578 502 (tridhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dy) lekë pa TVSH.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit dhe i transferohet Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për hartimin e studimprojektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit.

3. Fondet e mbetura të papërdorura pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” në buxhetin e shtetit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe